

VENDIM
Nr.422, datë 22.6.2011

**PËR LEJIMIN E EKSPOZIMIT TË TRI VEPRAVE NË PIKTURË, PJESË E KOLEKSIONIT
TË GALERISË KOMBËTARE TË ARTEVE, NË CETINJË TË MALIT TË ZI, NË KUADËR
TË SAMITIT TË KRERËVE TË SHTETEVE TË EUROPËS JUGLINDORE, NGA DATA 30
QERSHOR - 30 KORRIK, 2011**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 19 të ligjit nr.9048, datë 7.2.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e ekspozimit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë të tri veprave në pikturë: “Fshatari” e Sadik Kacelit; “Venecia” e Vangjush Mios; “Portret gruaje” e Zef Kolombit, pjesë e koleksionit të Galerisë Kombëtare të Arteve, në Cetinjë të Malit të Zi, në kuadër të samitit të krerëve të shteteve të Europës Juglindore, nga data 30 qershor - 30 korrik, 2011.

2. Ekspozimi jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë të bëhet në përputhje me udhëzimin nr.2, datë 18.3.2004 të Këshillit të Ministrave “Për lëvizjen e objekteve të trashëgimisë kulturore të luajtshme, me vlera të veçanta, kombëtare dhe unike, për restaurimin, studimin dhe ekspozimin jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë”.

3. Ngarkohen Galeria Kombëtare e Arteve të kryejë shoqërimin dhe kthimin e pikturave në vendin e origjinës pas mbarimit të veprimtarisë dhe Qendra e Inventarizimit të Pasurive Kulturore të kryejë regjistrimin e lëvizjes së objekteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletore Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha